

VENDIM
Nr. 404, datë 20.6.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË
PËRFITIMIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR, NGA PERSONAT ME STATUSIN E
TË VERBRIT DHE INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK, PËR
FATURËN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE FATURËN E TELEFONISË FIKSE**
(ndryshuar me VKM nr. 616, datë 22.9.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 12 të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën *3 000 (tre mijë) lekë në muaj*.

2. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën *3 000 (tre mijë) lekë në muaj*.

3. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar dhe individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestarë, u jepet një kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën *2 400 (dy mijë e katërqind) lekë në muaj*.

4. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën *1 000 (një mijë) lekë në muaj*.

5. Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të cilët kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën *1 000 (një mijë) lekë në muaj*.

6. Masa e kompensimit llogaritet dhe përfitohet pranë njësisë së qeverisjes vendore ku individi i verbër, paraplegjik dhe tetraplegjik, ka vendbanimin.

7. Përfituesit, objekti i këtij vendimi, përjashtohen nga kompensimi i çmimit të energjisë elektrike, të parashikuar në vendimin nr. 565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”.

8. Për përfitimin e kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse, të përcaktuara sipas pikave 1, 2, 3, 4 e 5 të këtij vendimi, individët duhet të paraqesin pranë administratorëve shoqërorë në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për të përfituar kompensim dhe deklaratën sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) certifikatë familjare, që vërteton se individi është anëtar i familjes, e cila rinovohet çdo fillim viti;

c) kopjen e kontratës me entin shpërndarës të energjisë elektrike;
ç) kopjen e librezës së energjisë elektrike, e cila dorëzohet çdo fillim viti;
d) kopjen e kontratës me entin e shërbimit të telefonisë fikse;
dh) kopjen e librezës së telefonisë fikse, e cila dorëzohet çdo fillim viti.
e) kopje të librezave të paraplegjikut dhe tetraplegjikut apo të verbërisë, të lëshuara nga Shërbimi Social Shtetëror.

9. Njësitë e qeverisjes vendore i shpërndajnë pagesat për kompensimin e faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse nga shërbimet bankare ose “Posta Shqiptare” sh.a.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2012, të përballohen nga fondet e miratuara për *Ministrinë përgjegjës për çështjet sociale*.

11. Ngarkohet *Ministri përgjegjës për çështjet sociale* të nxjerrë udhëzimin përkatës të këtij vendimi.

12. Vendimi nr. 83, datë 26.2.2001 i Këshillit të Ministrave “Për tarifat telefonike dhe për pagesat elektrike nga personat me aftësi të kufizuara”, i ndryshuar, shfuqizohet.

13. Ngarkohen Ministria e Financave, *Ministria përgjegjës për çështjet sociale* dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha